REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK
Nr. 12/92 Prot
Shkodër, më 12.07.2019

SHOQATA PROJEKTI SHPRESA

Nr. 86 Prot

Shkodër, më 01.08.2019

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot në Bashkinë Shkodër, me datë ___/___/_____, ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

**Bashkia Shkodër**, me adresë: rruga 13 Dhjetori, nr 1, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër **Znj. Voltana Ademi**, këtej e tutje e cilësuar si **Bashkia**

*Dhe*

***Shoqata "Projekti Shpresa"***, me adresë: rruga Arra e madhe, nr. 108, përfaqësuar nga **z. Luigj Mila,** madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar, identifikuar nga pasaporta/kartë identiteti me nr. **027905073** si dhe me nr NIPT-i **K47121001G**

### Të përgjithshme:

Projekti Shpresa është një organizatë e themeluar në vitin 1995 sipas vendimit te gjykates nr. 8/1 dt 20/07/2006 që ofron shërbim të përkujdesit rezidencial dhe ditor për fëmijë dhe të rinj, jetimë biologjik apo socialë, me aftësi ndryshe, dhe/ose të dalë nga institucionet publike të përkujdesit rezidencial, shtëpi fëmije apo Qendër Zhvillimi.

### NENI 1

### Objekti

Objekt i kësaj marrëveshje është përcaktimi i roleve dhe përgjegjësive për të dy palet në ofrimi i shërbimeve social – kulturore nepërmjet zhvilimit të Kampit Veror në territorin e Njësisë administrative Velipojë. Ky aktivitet do zhvilliohet nga data 1 Korrik 2018 deri me 15 Gusht 2018 dhe ka fokus pabeshtetjen e të rinjëve me aftësi ndryshe dhe të rinjëve që vijnë nga familje vunerabel.

**KOHËZGJATJA** e kësaj marrëveshje bashkëpunimi do të jetë nga data nënshkrimit të saj deri më datën 15 Gusht 2018

## NENI II

## Baza ligjore

-Ligji nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore,,.

-Ligji nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".

-VKM nr.822 date 6.12.2006 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar, në qendrat rezidenciale dhe ditore".

## NENI III

## Qëllimi

Kjo marrëveshje ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve institucionale midis Bashkisë së Shkodrës dhe Projektit "Shpresa" në zbatimin të Kampit Veror në territorin e Velipojës nga Projekti 'Shpresa" me qëllim mbështetjen e fëmijëve me aftësi ndryshe dhe fëmijëve nga familjet vulnerabel.

## NENI IV

## Rolet dhe përgjegjësitë e Shoqatës Projekti 'Shpresa''

1.Shoqata Projketi "Shpresa" merr përsipër organizmin dhe drejtimin e Kampit Veror në Njësin administrative Velipojë që ka si qëllim rritjen e aftësive edukative, sociale dhe kulturore tek fëmijët.

2.Zhvillon aktivitete në Kampin Veror me synim nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet fëmijeve, rritjen e shkathëtësis të jetës, zhvillimin e komunikimit dhe higjenes përsonale tek fëmijët.

3.Siguron materialet dhe mjetet e nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve në kuader të Kampit Veror.

4.Kujdeset për mirëmbajtjen dhe higjenen e ambjentit ku do zhvillohen aktivitet në kuader të kampit Veror.

5.Në rastë demtimi të mundshëm të ambjentit duhet të sigurojë zevendësimin dhe kthimin në gjendje të mëparshmë të objektit të demtuar.

**NENI V**

**Rolet dhe përgjegjësitë e Bashkisë Shkodër**

1.Bashkia Shkodër siguron ambjentet e nevojshme në terrritorin e Njësis administrative Velipojë për realizimin e aktiviteteve edukative, sociale dhe kulturore në kuader të Kampit Veror .
2.Bashkëpunon me Shoqaten Projekti "Shpresa"me synim sigurimin e mbarëvajtjes së aktiviteteve në kuader të zbatimit të Kampit Veror.
3.Të bashkërendojë me Shoqaten Projekti "Shpresa'' veprimtaritë që lidhen me funksionimin e progarmit të Kampit Veror pranë Njësis administrative Velipojë me synim arritjen e objektivave të vendosur.

**NENI VII**

**Dispozita të fundit**

1.Kjo Marrëveshje hartohet në katër kopje të barazvlefshme.
2.Palët pasi e lexuan marrëveshjen, me vullnetin e tyre të lirë e nënshkruan atë.
3.Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve, në rast të kundërt për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve palët mund t'i drejtohen Gjykatës kompetente.

| | |
|---|---|
| **PËR** | **PËR** |
| **BASHKINË SHKODËR** | **Shoqatën Projekti SHPRESA** |
| **KRYETAR** | **President** |
| **Voltana Ademi** | **Luigj Mila** |

# Shoqata Projekti Shpresa: 83/B

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË
VOLTANA ADEMI




stacion plazhi ne perdorim te subjektit